



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**URDH ËR**

**Nr. 226 Datë 19. 12. 2003**

**PËR  
MIRATIMIN E STRUKTURËS TË PROKURORIVE PËR KRIME TË RËNDA**

**Me synim,**

- organizimin e Prokurorisë për Krime të Rënda dhe Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda, si dhe;
- për të siguruar funksionimin normal të këtyre Prokurorive;

**Në mbështetje,** të nenit 8 pika 2 e vijues të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit Nr. 9110 datë 24. 07. 2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda", si dhe të Dekretit të Presidentit të Republikës Nr. 3993 datë 29. 10. 2003 "Për caktimin e kompetencës tokësore të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë dhe nurarit të gjyqtarëve të Gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit për krime të rënda",

**URDHËROJ:**

1. Krijimin e Prokurorisë për Krime të Rënda dhe Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda, të cilat janë struktura më vete brenda organit të Prokurorisë, që fillojnë funksionimin e tyre në datën 1 janar 2004.
2. Prokuroria për Krime të Rënda organizohet pranë Gjykatës për Krime të Rënda, me qendër në Tiranë, dhe ka kompetenca tokësore në të gjithë territorin e vendit.
3. Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda organizohet pranë Gjykatës të Apelit për Krime të Rënda në Tiranë, me kompetenca tokësore në të gjithë territorin e vendit.
4. Struktura organike e Prokurorisë për Krime të Rënda, të jetë, si më poshtë:

Nr	Emërtimi i Strukturës	Organika
1.	Drejtues i Prokurorisë	1
2	Zëvendësprokuror	2
3	Prokuror	17
4	Oficer të Policisë Gjyqësore	12
5	Kancelar	1
6	Sekretar I Drejtuesit të Prokurorisë	1
7	Shcf i financës dhe buxhetit	1
8	Sekretar - operator	10
9	Magazinjier - arkëtar	1
10	Zëdhënës shtypi	1
11	Ftues	1
12	Teknik mirëmbajtës	1
13	Punonjës shërbimi-informacioni	3
14	Shofer	12
15	Punonjës pastrimi	1

5. Struktura organike e Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda, të jetë, si më poshtë:

Nr	Emërtimi i Strukturës	Organika
1.	Drejtues i Prokurorisë	1
2	Zëvendësprokuror	1
3	Prokuror	2
4	Oficer të Policisë Gjyqësore	1
5	Kryesekretar	1
6	Specialist i financës dhe buxhetit	1
7	Sekretar - operator	2
8	Shofer	2
9	Punonjës pastrimi	1

6. Prokuroria për Krime të Rënda dhe Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda janë persona juridik, kanë vulë dhe llogari më vete në bankë,
7. Administrata e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, të marrë masa, për përgatitjen e vulave, për çeljen dhe transferimin e fondeve buxheto re, sigurimin e prokurorëve për krime të rënda në ambiente të përshtatshme, për ushtrimin e funksioneve të tyre.
8. Me fillimin e veprimtarisë së Prokurorisë për krime të rënda, të bëhet depozitimi i firmave në degët e thesarit sipas rregullave, të çelen librat e protokollit, rregjistri themeltar i punonjësve, librat e llogarisë dhe të kryhen veprime të tjera administrative për funksionimin normal të tyre.

9. Të mbahet regjistri përkatës i procedimeve në ndjekje dhe evidencat statistikore, në zbatim të urdhërit Nr. 284 datë 19. 12. 2002 "Për mbajtjen, plotësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore në Prokurori" dhe udhëzimit Nr. 289 datë 30. 12. 2002 "Për mënyrën e mbajtjes, ruajtjes dhe plotësimit të evidencave statistikore në Prokurori", me ndryshimet e bëra për veçorit e grupimit të krimeve të rënda.
10. Strukturat e kësaj Zyre dhe Sekretari i Përgjithshëm, të marrin masat e duhura për të përmbushur detyrimet përkatëse të parashikuara në ligj dhe në këtë urdhër, lidhur me fillimin në afat të veprimtarisë normale të Prokurorisë për Krime të Rënda dhe të Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda.
11. Për të ndjekur e kontrolluar zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen drejtuesit e Prokurorisë për Krime të Rënda dhe të Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda, drejtuesit e strukturës së Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe Sekretari i Përgjithshëm.
12. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

THEODHORI SOLLAKU



